



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
Opština Glogovac / Municipality of Gllogoc**



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/ Jedinica za Single Resource Manager

Bazuar në nenin 77,78,79,80,81 dhe nenin 82 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtares Publike, nenin 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, neni 16 i Ligjit nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 05/2015 e Normativit për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, neni 6, 7 dhe 12 i Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, nenit 8, nenit 9, nenit 10 dhe nenit 20 të Rregullores (QRK) 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucione Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, NJMBNJ shpallë:

KONKURS

(I jashtëm)

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në institucionet arsimore

Numri i references: RN00018373

Institucioni: Komuna e Drenasit/Gllogocit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim

Koficienti/paga: E17_6.8, E19_6.6, E20_6.2, E22_6

Data e njoftimit: 04.08.2025

Afati i aplikimit: 05.08.2025 deri 03.09.2025

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Periudha provuese: 6 muaj

1. SHFMU „Abedin Bujupi ” në Arllat

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 17 orë (8 orë në SHFMU „Abedin Bujupi ”- Arllat, 5 orë në SHFMU”Jusuf Gërvalla”-Negroc, 4 orë në “M.S.Bytyqi”-Bytyq), me kohë të pacaktuar.

2. SHFMU „Shotë Galica ” në Abri e Epërme

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Shotë Galica ” në Abri e Epërme, 4 orë në SHFMU”Migjeni”-Baicë, 4 orë në SHFMU “Gani Elshani”-Kroikovë + 4 orë në SHFMU “Naim Frashëri”- Gillobar, me kohë të pacaktuar.

3. SHFMU „Hasan Prishtina” në Llapushnik

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Hasan Prishtina ” në Llapushnik, 8 orë në SHFMU”Halil Bajraktari”-Drenas II, dhe 4 orë në SHFMU “Fazli Grejqevci”-Vasilevë, me kohë të pacaktuar.

4. SHFMU „Ali Gashi” në Çikatovë e Re

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Ali Gashi ” në Çikatovë e Re , 4 orë në SHFMU”Azem Bejta”-Shtuticë,4 orë në SHFMU “Dëshmoret e Fortesës”-Verboc, dhe 4 orë në SHFMU “Shaban Polluzha” - Polluzhë), me kohë të pacaktuar.

5. SHFMU „Fehmi dhe Islam Kastrati” në Kishnarekë

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU “ Fehmi dhe Islam Kastrati ” në Kishnarekë, 8 orë në SHFMU”Bajram Curri”-Nekoc + 4 orë SHFMU” Zenel Hajdini” në Tërstenik), me kohë të pacaktuar.

6. SHFMU „ Xheladin Gashi-Plaku” në Komoran

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Xheladin Gashi-Plaku ” në Komaran , 8 orë në SHFMU”Luigj Gurakuqi”-Sankoc,dhe 4 orë në SHFMU “24 Korriku”-Fushticë e Poshtme), me kohë të pacaktuar.

7. SHFMU „ Arif Shala” në Korroticë e Poshtme

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU “Arif Shala”-Korroticë e Poshtme, 5 orë në SHFMU”Shaban Polluzha”-Korroticë e Epërme,dhe 4 orë në SHFMU “Dëshmoret e Qëndresës II” – Tërstenik), me kohë të pacaktuar.

8. SHMP” Fehmi Lladrovci”- Drenas

-Një mësimdhënës i Gjuhës Gjermane, me 20 orë, me kohë të pacaktuar.

-Një mësimdhënës për lëndën Konfeksion – Dizajn, me 10 orë, me kohë të pacaktuar.

-Një (1) mësimdhënës lëndën Ekonomi, me 10 orë, me kohë të pacaktuar.

9. SHML”GJ.K.Skënderbeu”-Drenas

-Dy mësimdhënës/e të Gjuhës Gjermane, me 20 orë, me kohë të pacaktuar.

10. SHFMU” Rasim Kiçina” në Drenas

- Një mësimdhënës/e për Art Figurativ, me 20 orë, më kohë të pacaktuar.
- Një mësimdhënës/e për Matematikë, me 20 orë, më kohë të pacaktuar.

11. SHFMU” Mehdi Bytyqi” në Arllat

- Një mësimdhënës për Arsim Fillor, më kohë të pacaktuar,
- Një mësimdhënës për Histori, Edukatë Qytetare, me 13 orë, më kohë të pacaktuar.

12. SHFMU ”Ali Gashi” në Çikatovë e Re

- Një mësimdhënës/e për TIK-ut, me 20 orë, prej tyre 12 orë në SHFMU” Ali Gashi” në Çikatovë e Re dhe 8 orë SHFMU” Rilindja” në Dobrashevc, më kohë të pacaktuar.

13. SHFMU ”Halil Bajraktari ” në Drenas II

- Një mësimdhënës/e Gjuhës Shqipe, me 18 orë, më kohë të pacaktuar.

14. SHFMU” Fehmi dhe Islam Kastrati “ në Kishnarekë

- Një mësimdhënës/e për Histori – Edukatë Qytetare, me 20 orë për kohë të pacaktuar.
- Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze, me 20 orë, prej tyre 10 orë në SHFMU” Fehmi dhe Islam Kastrati “ në Kishnarekë dhe 10 orë në SHFMU” Bajram Curri” në Nekoc, më kohë të pacaktuar

15. SHFMU” Fazli Greiçevci” në Poklek – Vasilevë

- Një mësimdhënës/e për Biologji – Kimi, më 20 orë, prej tyre 8 orë Biologji në SHFMU” Fazli Greiçevci” në Poklek – Vasilevë , 6 orë në SHFMU” Zenel Hajdini” në Tërstenik dhe 6 orë SHFMU” Dëshmoret e Fortesës “ në Vërbovc, më kohë të pacaktuar.

16. SHFMU” Naim Frashëri “ në Gllobar

- Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe, me 20 orë, më kohë të pacaktuar.

17. SHFMU” Luigj Gurakuqi ” në Sankoc

- Një mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe, me 18 orë, më kohë të pacaktuar.

18. SHFMU” Jusuf Gërvalla ” në Negroc

- Një mësimdhënës/e për Histori, me 10 orë, më kohë të pacaktuar.

19. SHFMU” Gani Elshani” – Kraikovë

- Një mësimdhënës/e për Matematikë, me 16 orë, më kohë të pacaktuar.

20. SHFMU” Azem Bejta” – Shtuticë

-Një mësimdhënës për Biologji – Kimi, me 14 orë, prej tyre 8 orë Biologji në SHFMU” Azem Bejta” - Shtuticë dhe 6 orë Kimi në SHFMU” Gani Elshani” në Krojkovë.

21. SHFMU” Mehmet Gradica “ në Gradicë

-Një mësimdhënës/e për Arsim Fillor, më kohë të pacaktuar

22. QEAP “ Ardhmëria” në Drenas/Komoran

-Shtatë (7) edukator/e, më kohë të pacaktuar.

1.Detyrat dhe përgjegjësitë: Mesimdhënësit/es

1. Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës.
2. Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
3. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
4. Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon.
5. Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
6. Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së.
7. Të mos e shfrytëzoj pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.
8. Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
9. Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
10. I punësuari është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.
11. I punësuari sipas kësaj kontrate, nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.
12. Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë: Edukatore

- Edukatorja realizon direkt punën edukativo-arsimore me fëmijët të moshës 3-6 vjeç;
- Përgatit dhe planifikon punën vjetore, mujore, javore dhe ditore me qëllim të realizimit të detyrave programore;
- Planifikon aktivitete ditore me fëmijë ,si takimet e mëngjesit, nëpër qendra të aktivitetit, aktivitete të lira (shfrytëzimin e faktorit natyror) si dhe aktivitetet e pasdites;
- Organizon pranimin e fëmijëve në mëngjes si dhe përcjelljen e tyre, përgjegjëse është për sigurimin fizik të fëmijëve, mirëpret me ngrohtësi si dhe ofron përjetimin e sigurisë;
- Punon në kultivimin e shprehive të punës, shprehive kulturore-higjienike, shprehive pushim aktiv(gjumë)veshjes - në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që i shtron Kopshti;
- Të inkurajohet fëmijëve zhvillimi gjuhësor dhe komunikimeve tjera për përdorimin efikas dhe kreativ të gjuhës, që më vonë të ndihmoj në lexim dhe shkrim;
- Të inkurajohet fëmijëve aftësia dhe shprehja artistike, zhvillimi fizik, higjiena personale dhe në kujdesin e shëndetit të tyre;
- Planifikon ,organizon dhe realizon programin e bashkëpunimit me komunitetin;
- Merr pjesë në planifikimin dhe sigurimin e materialit didaktik për punën edukativo – arsimore;
- Mban dhe evidenton me kohë dokumentacionin pedagogjik, në realizimin e detyrave programore;
- Merr pjesë në punën e organeve ,këshillave, tubimeve profesionale;
- Merr pjesë aktive në veprimtarit kulturore të institucionit(programe ekspozitë, manifestime) ;
- Sistematikisht punon në ngritjen e vetë profesionale(përcjell literaturën profesionale, merr pjesë në trajnime, seminare dhe aktive profesionale);
- Kryen punën e mentorit (në raste se caktohet për këtë detyrë);
-

3. Kandidatët e interesuar për të konkurruar për personel edukativo-arsimor duhet t'i plotësojnë këto kushte, dhe në momentin e aplikimit të sjellin dokuemntet si më poshtë:

- 3.1.Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës (letërnjoftimin, patent shoferin apo pasaportën);
- 3.2. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse
 - 3.2.1.Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi, (Vërtetim nga Qendra për Punës Sociale);
 - 3.2.2.Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- 3.3.Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- 3.4. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

- 3.5. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik, vlenë për të punësuarit ose ata që kanë qenë të punësuar në institucione publike, (kandidatët që nuk kanë qenë të punësuar në institucione publike dorëzojnë vetëm një vetëdeklarim me shkrim);
- 3.6. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës (të noterizuar/ kopje);
- 3.7. Vërtetimin e përvojës së punës në mësimdhënie, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
- 3.8. Licencën e mësimdhënësit/es, sipas procedurave për lëshimin e licencës për mësimdhënës/e, nëse një gjë e tillë nuk është shfuqizuar përmes një akti nënligjor të MASHTI për rregullimin e provimit shtetëror të mësimdhënësit;
- 3.9. Përgjashtimisht për kandidatët që konkurrojnë për pozitën e mësimdhënësit/es fillestar/e, nuk kërkohet përmbushja e kriterit të parashikuar në paragrafin 6.
- 3.10. Dëshminë për përfundimin e suksesshëm të provimit shtetëror për mësimdhënës/e sipas legjislacionit përkatës për profesionet e rregulluara, nëse një provim i tillë është bërë i detyrueshëm për të ushtruar profesionin e mësimdhënësit/ses përmes një akti tjetër nënligjor të MASHTI;
- 3.11. Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje.
- 3.12. Kandidatët që kanë përvojë pune dorëzojnë edhe portfolio profesionale me përmbledhjen e punës së tyre.
- 3.13. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
- 3.14. Përgjashtimisht paragrafit shtetasit e huaj mund të aplikojnë kur kjo lejohet sipas legjislacionit në fuqi për zyrtarët publik.

Kualifikimi, përvoja, aftësit dhe shkathhtësit tjera:

- Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2015 dhe Ligjir nr.04/L- 037
- Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi.
- Përvoja e punës nuk kërkohet.

Sqarim: Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka kualifikim adekuat, do të veprohet sipas nenit 12 të Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i cili thotë : në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të nivelit master arsimor, sistemi katërvjeçar dhe baçelor katërvjeçar, mund të pranohen niveli baçelor trevjeçar për një vit shkollor, ku të punësuarit sipas këtij neni, pas përfundimit të kontratës 1 vjeçare, i shpallet konkursi sipas legjislacionit në fuqi.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit (deri 20 %)
- Testi më shkrim (deri 50 %)
- Intervista me gojë (deri 30 %)

Procedurat e konkurimit:

Konkurimi është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa dallim, të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit, dispozitat e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyraret Publikë, Rregullores (QRK) nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve, mësimdhënësve, bashkpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe Sekretarëve në institucioneve publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 si dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Njoftim: Kandidatët të cilët i kalojnë fazën e testimit me shkrim dhe intervistës, dhe marrin pikë të mjaftueshme për të kaluar fazën kualifikuese dhe nuk pranohen në punë, do të jenë pjesë e Listës së kandidatëve fitues (listës pritëse), të cilët do të angazhohen në sipas nevojave të paraqitura gjatë vitit akademik shkollor, ashtu si është paraparë me rregulloren (QRK) nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve, mësimdhënësve, bashkpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar.

Informata të përgjithshme:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në Zyrën për Shërbim me Qytetarë, nga ora 08:16 çdo ditë pune, në sportelet 10,11,12 në Komunën e Drenasit, aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga web-faqja <https://konkursi.rks-gov.net/> .

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen/tërhiqen, prandaj ato duhet të dorëzohen vetëm kopje.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi përmes email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumentet origjinale të kualifikimeve që i kanë kryer.

Në rast të mos dorëzimit të dokumentacionit origjinal, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet do të publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>.